Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial	**P2**

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 03.10.2020

CONTENT / PËRMBAJTJA

SESSION	**MAXIMUM ASSIGNED**	-ATTENTION! THIS PART IS FOR SCAAK USE ONLY- **MARKS AWARDED**
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
4. Problem 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Të dhënat në vijim të kompanisë ABC i përkasin prodhimtarisë së 2,000 copë vazo nga deltina gjatë Korrikut.

Materialet direkte (të gjitha materialet e blera janë shfrytëzuar):

Çmimi standarde:	€6.00 për kg të vazës.
Gjithsej çmimi aktuale:	€11,200.
Çmimi standard i lejuar për njësitë e prodhuara ishte	€12,000.
Varianca e efikasitetit të materialeve ishte	€240 e pafavorshme (PFV).

Puna direkte:

Çmimi standard është 2 vazo për orë	€24.00 për orë.
Çmimi aktual për orë ishte	€24.50.
Varianca e efikasitetit e punës ishte	€672 favorshme (FAV).

Kërkohet:

a. Sa është sasia standarde e materialit për prodhimin e një vazoje? (5 pikë)
b. Sa është varianca e çmimit të materialeve direkte (MD)? (4 pikë)
c. Sa është gjithsej çmimi aktual për punën direkte (PD)? (6 pikë)
d. Sa është varianca e çmimit për punën direkte? (5 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhja 1

a. Kosto standarde per vazo = €12,000/2,000 = €6.00 per vazo

KG standard per vazo = €6.00/€6.00 = **1.0 kg per vazo**

b. Varianca e cmimit te MD = Varianca totale + Varianca e efikasitetit (sasisë)

= (€12,000 – €11,200) + €240 PFV

= €1,040 FAV

c. Cmimi actual i PD per oret aktuale = ((2,000/2) x €24) - €672 = €23,328

Oret Aktuale = €23,328/24 = 972 ore

Kostot totale aktuale = 972 x €24.50 = **€23,814**

d. Varianca e cmimit per PD = €23,814 - €23,328

= €486 PFV

Problemi 2

MOZIK Corporation përdor metodën FIFO për nxjerrjen e njësive ekuivalente. Më poshtë kemi të dhënat e kompanisë për punën në proces në muajin Prill:

Puna në proces (stoqet në fillim):	
Njësit e stoqeve në fillim të punës në proces	300
Kostoja e matrialeve në fillim të punës në proces	€5,900
Shpenzimet e konvertimit në fillim të punës në proces	€3,000
Përqindja e kompletimit sa i perket materialeve të punës në proces në fillim	85%
Përqindja e kompletimit të njësive sa i përket shpenzimeve të konvertimit të punës në proces në fillim	20%
Njësit e filluara gjatë muajit	5,300
Njësit e transferuara jashtë punës në proces gjatë muajit	4,800
Kostoja e materialeve të blera gjatë muajit	€105,900
Shpenzimet e Konvertimit gjatë muajit	€225,200
Puna në proces (Stoqet në fund)	
Njësitë e stoqeve në fund të punës në proces	800
Përqindja e kompletimit të njësive sa i përket materialeve të punës në process në fund	50%
Përqindja e kompletimit të njësive sa i përket shpenzimeve të konvertimit të punës në proces në fund	40%

Kërkohet:

(a) Sa janë njësit ekuivalente sa i perket materialeve në muajin prill ? (2 pikë)

(b) Sa janë njësitë ekuivalente sa i përket shpenzimeve të konvertimit në muajin prill ? (3 pikë)

(c) Sa janë shpenzimet për njësi ekuivalente sa i përket materialeve në muajin prill ? (3 pikë)

(d) Sa janë shpenzimet për njësi ekuivalente sa i përket shpenzimeve të konvertimit në muajin prill ? (3 pikë)

(e) Sa është shpenzimi për njësi ekuivalente në muajin prill ? (3 pikë)

(f) Sa është vlera e shpenzimeve totale të transferuara jashtë punës në proces ? (3 pikë)

(g) Sa është vlera e shpenzimeve të punës në proces në fund ? (3 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhje 2

(a) (300 x 15%) + 4500 + (800 x 50%) = **4,945 Njësi Ekuivalente**

(b) (300 x 80%) + 4500 + (800 x 40%)= **5,060 Njësi Ekuivalente**

(c) (105,900/4,945) = **21.42€ / njësi**

(d) (225,200/ 5,060) = **44.50€ / njësi**

(e) (44.50+21.42) = **65.92€ / njësi**

(f) (5,900+3,000) + (105,900+225,200) – [(400x21.42)+(320x44.51)] = **317,188.80€**

(g). [(400x21.42) + (320x44.51)] = **22,811.20€**

Problemi 3

(a) ABC prodhon dhe shet një lloj të vetëm të produktit. Çmimi i shitjes për njësi është 50 Euro, dhe Marxhina Variabile 30% e shitjeve. Shpenzimet fikse mujore të kompanisë janë 25,000Euro.

Nëse ABC deshiron që të arrijë një fitim operativ 10,000€, sa njësi duhet ti prodhoj dhe ti shesë ? Sa qarkullim (shitje) duhet te kete ? Sa eshte pragu i rentabilitetit ne njesi dhe ne EURO ? (Tregoni kalkulimet) ? (5 pike)

(b) Vitin e kaluar ABC ka rapotuar një fitim operativ prej 70,000 Euro, dhe shitjet totale ishin 520,000. Margjina variabile ishte 40% e të hyrave.

Nëse shpenzimet fikse rriten për 10,000 Euro vitin e ardhshëm, sa duhet të jenë shitjet e kompanisë për të arritur një fitim operativ prej 80,000Euro ? (5 pike)

(c) Më poshtë shohim të dhënat e buxhetuara për Runstram Company :

Shitjet …….500,000 Euro
Shpenzimet Variabile ……..350,000 Euro
Shpenzimet Fikse …….105,000 Euro

(c1) Sa është margjina variabile për Runstram Company në EURO dhe në Përqindje? *(5 pike)*

(c2) Sa duhet të jetë vlera e shitjeve totale si dhe e njesive nese cmimi eshte 10€/njësi, për të arritur pikën e rentabilitetit ? *(5 pike)*`

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhje 3

(a) Shitjet (njesi) ne Pragun e Rentabilitetit

= (€25,000) / (€50 - €35) = 1,667 njesi (apo 83,334€)

Njesite ne fitimin e synuar :

= (25,000€ + 10,000€) / (50€ - 35€) = 2,333 njesi (apo 116,667€ qarkullim).

(b) (10,000+10,000)/0.40 = 50,000€

……..€50,000 + €520,000 = **570,000€ (qarkullimi/shitjet e nevojshme totale per te arritur fitimin operativ prej 80,000€).**

C1). 500,000 – 350,000 = €**150,000 apo (150,000€/500,000 x 100 = 30%)**

C2). Marzha variabile = (500,000-350,000) / 500,000€ = **30% (0.30)**

(105,000€ / 0.30) = **€350,000€** apo (350,000€ / 10€/njesi = **35,000 njësi)**

Problemi 4

Bardhi Company prodhon qirinjë . Qendra iformative e kostove të tij na jep informatat si më poshtë:

Prodhimi vjetor	**10,000 njësi**
Kostot variabile për njësi:	
Matrialet direkte	€ 2.00
Puna direkte	€ 3.00
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabile	€ 1.00
Shpenzimet e shitjes dhe administrative variabile	€ 3.00
Kostot fikse:	
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit fikse	€20,000
Kostot fikse të shitjes dhe administrative	€ 5,000

Qirinjët shitën për €12.00 për një kuti. Kompania shet 9,000 kuti me qirinjë.

Kërkohet:

a) Kalkuloni koston e produktit për njësi nën trajtimin absorbues dhe variabil. (10 pike)
b) Përgatiteni një pasqyrë të të ardhurave nën dy metodat – Absorbues dhe Variabil (10 pike)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhje 4:

(a)

Kosto e prodhimit – Trajtimi absorbues

Materialet direkte		€2.00
Puna direkte		€3.00
Shpp variabile	€1.00	
Shpp fikse	€2.00	(€20,000 pjesëtuar për 10,000 njësi)
Totali		€8.00

Kosto e prodhimit – Trajtimi variabil:

Materialet direkte		€2.00
Puna direkte		€3.00
Shpp variabile	€1.00	
Totali		€6.00

(b)

Pasqyra e të ardhurave – Trajtimi absorbues:

Shitjet (9,000 njësi @ €12)			€108,000
KMSH:			
Stoqet në fillim		€ 0	
Kosto e mallrave të prodhuar		(10,000 njësi @ €8)	80,000
Minus: stoqet në fund	(1,000 unjësi @ €8)	8,000	72,000
Fitimi bruto			€ 36,000
Minus shpenzimet e shitjes dhe administrative:			
Variabile (9,000 njësi x €3)		€27,000	
Fikse		5,000	32,000
Fitimi neto		€ 4,000	

Pasqyra e të ardhurave – Trajtimi variabil:

Shitjet (9,000 njësi @ €12)			€108,000
KMSH:			
Stoqet në fillim		€ 0	
Kosto e mallrave të prodhuar	(10,000 njësi @ €6)		60,000
Minus: stoqet në fund	(1,000 njësi @ €6)	6,000	54,000
Fitimi bruto		€54,000	
Minus shpenzimet e shitjes dhe administrative:			
Variabile (9,000 njësi x €3)		€27,000	
Fikse		5,000	
Minus shpenzimet fikse të prodhimit			20,000 52,000
Fitimi neto			€ 2,000

Problemi 5

(a) Për çdo muaj ABC LLC prodhon dhe përdor 15,000 njësi të një pjese që është përbërëse e njërës nga produktet e saj kryesore (pjesë ndërmjetëse). Kostoja e Dobb për t'i prodhuar këto 15,000 pjesë është:

Përshkrimi i kostos	**Kostoja për njësi**	**Kostoja totale për 15,000 njësi**
Direkte e materialit (lëndës së parë)	€ 14.00	€ 210,000
Direkte e punës	€ 10.00	€ 150,000
Kosto të tjera variabile të prodhimit	€ 11.00	€ 165,000
Kosto fikse të prodhimit	€ 6.00	€ 90,000
Kostoja totale	€ 41.00	€ 615,000

Kerkohet:

Supozojmë që numri i njësive që prodhohen nga ABC LLC rritet për 20% në18,000 njësi. Plotësojeni tabelën e mëposhtme e cila tregon koston e re për njësi dhe koston totale për 18,000 njësi. (10 pikë)

Përshkrimi i kostos	**Kostoja për njësi**	**Kostoja totale për 18,000 njësi**
Direkte e materialit (lëndës së parë)		
Direkte e punës		
Kosto të tjera variabile të prodhimit		
Kosto fikse të prodhimit		
Kostoja totale	Nuk kërkohet	Nuk kërkohet

(b) Dyqani i sendviçëve ALMA ka planifikuar këto kosto për një muaj në të cilin do të pregatiten dhe të shiten 1,500 sandviçë:

Përshkrimi	**Kostot totale për 1,500 sandviçe**
Direkte e materialit	€ 1,875
Direkte e punës	1,500
Qiraja	1,200
Amortizimi	300
Kosto të tjera fikse	900
Gjithsej	**€ 5,775**

Kërkohet:

1. Sa është kostoja variabile e planifikuar (e buxhetuar) për njësi nëse 1,000 sandviçe janë pregatitur dhe janë shitur?

2. Sa është kostoja totale variabile e planifikuar (e buxhetuar) nëse janë pregatitur dhe janë shitur 1,000 sandviçë?

3. Sa është kostoja totale fikse e planifikuar (e buxhetuar) nëse janë pregatitur dhe shitur 1,000 sandviçe?

4. Sa është kostoja fikse e planifikuar (e buxhetuar) për njësi nëse janë pregatitur dhe shitur 1,000 sandviçë?

5. Sa është fitimi total i planifikuar (e buxhetuar) nëse janë pregatitur 1,000 sandviçë dhe janë shitur për €6 secili?

(5x2 pike = 10 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhjet - 5

(a)

Përshkrimi i kostos	Kostoja për njësi	Kostoja totale për 18,000 njësi
Direkte e materialit (lëndës së parë)	€ 14.00	€ 252,000
Direkte e punës	€ 10.00	€ 180,000
Kosto të tjera variabile të prodhimit	€ 11.00	€ 198,000
Kosto fikse të prodhimit	€ 5.00	€ 90,000
Kostoja totale	**Nuk kërkohet**	**Nuk kërkohet**

(b)

1. Sa është kostoja variabile e planifikuar (e buxhetuar) për njësi nëse 1,000 sandviçe janë pregatitur dhe janë shitur? = €2.25 (1.25€/njësi + 1.00€/njësi)

2. Sa është kostoja totale variabile e planifikuar (e buxhetuar) nëse janë pregatitur dhe janë shitur 1,000 sandviçë? = €2,250 (€2.25 * 1000 njësi)

3. Sa është kostoja totale fikse e planifikuar (e buxhetuar) nëse janë pregatitur dhe shitur 1,000 sandviçe? = 2,400€ (qiraja+amortizimi+kostot tjera).

4. Sa është kostoja fikse e planifikuar (e buxhetuar) për njësi nëse janë pregatitur dhe shitur 1,000 sandviçë? = 2.4€ (2,400€/1,000 njësi).

5. Sa është fitimi total i planifikuar (e buxhetuar) nëse janë pregatitur 1,000 sandviçë dhe janë shitur për €6 secili? = 1,350€ (6,000€ - 2,250€ - 1,350€).